



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:036586
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05827908

C.nr.1469/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.Z. nga fshati, B.A., B.M., dhe B.S., të gjithë nga Gjilani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson M.H., avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi në emër të kualifikimit, vlera e kontestit 6,121.92 euro, jashtë seancës, me datë 07.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.Z. nga fshati, B.A., B.M., dhe B.S., të gjithë nga Gjilani nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që për periudhën kohore 01.02.2021 – 31.01.2023, për 24 muaj:

Paditësit A.M. në emër të kualifikimit master, duke llogaritur nga 89.03 euro për çdo muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,136.72 euro;

Paditësit B.A. në emër të kualifikimit bachelor, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,328.4 euro;

Paditëses B.M. në emër të kualifikimit bachelor, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,328.4 euro;

Paditëses B.Z. në emër të kualifikimit bachelor, duke llogaritur nga 55.35 euro për çdo muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,328.4 euro;

Të gjitha, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 23.01.2024 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 321.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuares së tyre, më datë 23.01.2024 kanë paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin në emër të kualifikimit, në vlerë të kontestit prej 6,121.92 euro.

Në padi ka theksuar se të njëjtit janë të punësuar te e paditura në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Ramiz Cernica” në Cernicë, në cilësinë e mësimeve, sipas kontratës së punës me kohë të pacaktuar. Përkundër kualifikimit të paditësit të parë me master, e të tjerëve me bachelor, të njëjtit asnjëherë nuk janë kompensuar për atë që e përcakton baza ligjore për kualifikim nga e paditura si punëdhënëse, edhe pse ky ka qenë detyrim i së njëjtës. Për periudhën 01.02.2021 – 31.01.2023, të njëjtit janë kompensuar vetëm në shumën prej 58.32 euro për çdo muaj, ndërsa paditësi i parë është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro (sipas 35 % të pagës bazë), e paditësit e tjerë është dashur të paguhet në shumën prej 113.67 euro (sipas 27 % të pagës bazë), me ç’rast e paditura ia ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro paditësit të parë e 55.35 euro në paditësve të tjerë. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 260.00 euro, për përpilim të padisë dhe 61.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të kualifikimit/licencës, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie punë tek e paditura në SHFMU “Ramiz Cernica” në Cernicë (fakt i vërtetuar nga vërtetimet nr.prot.145, 146, 147 dhe 148 të dt.17.11.2023 të lëshuara nga kjo shkollë) dhe pagën bazë e kanë në lartësi prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim paguhen në shumën prej 58.32 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësve nga Buxheti i Republikës së Kosovës).

Nuk është kontestuese se paditësi A.M. është i kualifikuar me master nga Kolegji AAB (diploma nr.362/12 e dt.31.08.2012) dhe është mësimdhënës i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100001701 e dt.11.09.2012).

Paditësi B.A. është i kualifikuar me bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (diploma nr.294 e dt.26.03.2015) dhe është mësimdhënës i licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100001702 e dt.11.09.2012).

Paditësja B.M. është e kualifikuar me bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (diploma e dt.23.03.2009) dhe është mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100001703 e dt.11.09.2012).

Paditësja B.Z. është e kualifikuar me bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (diploma nr.253 e dt.16.11.2011) dhe është mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.100020285 e dt.20.05.2014).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga kjo, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësve pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht paditësit të parë me kualifikim master e paditësve të tjerë me kualifikim bachelor, pasi të njëjtit janë paguar në shumën prej 58.32 euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagës), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, paditësi i parë është dashur të paguhet në shumën prej 147.35 euro, e paditësit e tjerë në shumën prej 113.67 euro, me ç'rast e paditura i ka mbetur borxh në shumën prej 89.03 euro paditësit e parë e 55.35 euro paditësve të tjerë, ndërsa periudha e kërkuar për këtë kompensim përfshin kohën sa ka qenë në fuqi Vendimi i Qeverisë dhe nuk është nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 23.01.2024, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 01.02.2021.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësve në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1469/24, më datë 07.06.2024

Gjyqtarja,
Erlinda Elezi-Tosku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.